



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-111/01-12785

Datë 22.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 80 dhe 82 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212, si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Pranimit për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitat *administrative dhe mbështetëse në Pylltari*, sipas konkursit me numër 01-111/01-12785 të datës 22.06.2023.
2. Komisionin e Pranimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Dervish Tahiri – Kryesues
  - 2.2. Teuta Krasniqi – Anëtare
  - 2.3. Xhavit Hasani – Anëtarë
3. Komisioni i Pranimit, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procedurave të vlerësimit nëpërmjet jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. Komisioni pas përfundimit të procedurës së rekrutimit shpërbëhet menjëherë.

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 80 dhe 82 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212, si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar në pozitat *administrative dhe mbështetëse në Pylltari*, në konkursin me numër 01-111/01-12785 të datës 22.06.2023, u caktua komisioni që të bëjë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

#### Vendimi iu dorëzohet:

- Komisionit të Pranimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës